



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 86, datë 31.05.2021**

**PËR  
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË EMETIMIT  
DHE PRODHIMIT TË POLICAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 60, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i ndryshuar, nenit 42, pika 8, të Ligjit nr. 10076 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe nenit 14, pika 1 dhe 3, të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010 “Për standartet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E:**

Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, hyn në fuqi më datë 1 korrik 2021. Duke filluar nga kjo datë, kontrata e sigurimit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe shoqëritë e sigurimit duhet të lëshojnë kontrata sigurimi në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Byroja Shqiptare e Sigurimit, me shkresat nr. 1866 prot, datë 18.05.2021, ka depozituar në Autoritet vendimin nr. 08, datë 18.05.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve “Për prodhimin e policave të sigurimit të detyrueshëm TPL Kufitare” (me nr. 21 përpara) dhe policën e pasagjerit për vitin 2021, sipas Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të policave të sigurimit të detyrueshëm TPL, Kufitare dhe policat e pasagjerit të emetuara për vitin 2021, sipas Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009”, shoqëruar me specimenet përkatëse.

Nga shqyrtimi i specimeneve të policave të depozituara, rezulton se janë hartuar në përputhje me kërkesat e nenit 15, të Ligjit nr. 32/2021, neneve 60 e vijues të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”.

Në këto kushte, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

#### **V E N D O S I:**

- 1. Dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurave për emetimin dhe prodhimin e policave të sigurimit të detyrueshëm, sipas specimeneve të miratuara me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të BSHS, nr. 8, datë 18.05.2021.**
- 2. Vendimi i Bordit nr. 85, datë 22.06.2012 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, si dhe vendimi i Bordit nr. 258, datë 30.12.2019 “Për dhënien e pëlqimit për fillimin e procedurave të emetimit dhe prodhimit të policës së sigurimit kufitar”, shfuqizohen.**
- 3. Ngarkohet Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe Departamentet përkatëse të Autoritetit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**